


Përdorimi i platformës Zoom - zoom.us

Zoom është një platformë që ofronë shërbime për takime/meetings në distancë (zoom.us). Kjo platformë ofron mundësinë e kyçjes deri 100 pjesëmarrës në një takim pa pagesë, mirëpo me kohëzgjatje të limituar prej 40 minutash (për versionin pa pagesë). Për një numër më të madh të pjesëmarrësve dhe kohëzgjatje të pa kufizuar ekzistojnë versionet me pagesë (<https://zoom.us/pricing>).


Parakusht për të krijuar takimin ose për tu lidhur në një takim, duhet të krijoni llogari dhe ta keni të instaluar aplikacionin Zoom në kompjuterin/tabletin/telefonin tuaj.

Si të krijoni llogari


Hyni në <https://zoom.us/> pastaj klikoni SIGN UP si më poshtë:




Pastaj mund të krijoni llogari duke përdorur email private ose duke klikuar **Sign in with Google** ose **Sign in with Facebook**.




Ju rekomandojmë krijimin e llogarisë duke klikuar **Sign in with Google**, dhe pas klikimit do të ju shfaqet forma ku duhet ta plotësoni me emailin tuaj



Pastaj fjalëkalimin e e-maili-it tuaj:




Dhe klikoni Create Account:



Si ta shkarkoni aplikacionin Zoom


Aplikacioni mund të shkarkohet duke shkuar te [RESOURCES](#) në web dhe klikoni

Download Zoom Client:



Dhe klikoni **Download**:

1



Kyçu në një takim

- Hape aplikacionin Zoom.
- Bashkoju ne nje takim duke perdorur nje nga menytrat me poshte:

Kliko **Join a Meeting** nese deshiron te bashkangjitesh ne nje takim pa u kyçur.



Join a Meeting

Sign In

Ose kyçu në Zoom pastaj kliko **Join**



Join

Vendosni numrin e [ID së takimit](#) dhe emrin tuaj.

- Nëse jeni identifikuar, ndryshoni emrin tuaj nëse nuk doni që të shfaqet [emri juaj i paracaktuar](#).

Nëse nuk jeni identifikuar, shkruani një emër.

Join a Meeting

Meeting ID or Personal Link Name

Grant MacLaren

- Do not connect to audio
- Turn off my video

Join

Cancel

Zgjidhni nëse dëshironi të lidheni audio dhe / ose video dhe klikoni Join. Kyçu dhe bashkangjitu në një takim (Sign in and Join)

Pas startimit të aplikacionit Zoom, klikoni në butonin [join a meeting](#) për tu bashkangjitur në një takim/meeting pa pasur nevojë të jeni të kyçur. Nëse dëshironi të kyçeni dhe të organizoni një

takim, klikoni Sign In.



Join a Meeting

Sign In

Për tu kyçur, përdoni llogarinë e juaj të Zoom, Google ose Facebook. Ju gjithashtu mund të kyçeni duke përdorur SSO (log in using SSO). Nëse nuk keni një llogari, Klikoni në Sign Up Free. Nëse keni një Zoom llogari mirëpo nuk mund ta kujtoni fjalëkalimin, klikoni Forgot.

Sign In

[Sign Up Free](#)

Email

Password

[Forgot?](#)

Keep me signed in

Sign In



Sign In with SSO



Sign In with Google




Sign In with Facebook

or

[← Back](#)

Home

Pas kyçjes, ju do të shihni faqen Home, ku do të mund të shihni këto opsione:



New Meeting: Fillo nje takim/meeting (instant meeting).

Kliko shigjetë poshtë për aktivizuar video-n ose për të përdorur ID-në personale tuaj të takimit ([personal meeting ID \(PMI\)](#)).

- Join: Bashkangjitu në një takim([Join a meeting](#)) që është në progres (duke ndodhur)
- Schedule: Caktoni një takim/meeting të ardhshëm ([Set up a future meeting](#)).
- Share Screen: [Ndaje ekranin tuaj me të tjerët në një takim](#) të krijuar nga dikush tjetër duke shkruar ID-në e takimit/meeting.

Upcoming meeting: Shfaq takimin e rradhës për ditën aktuale.

1:1 The Director Start


02:00 PM - 03:00 PM

Meeting ID: 349-145-042

Host: Grant MacLaren

[View today's upcoming meetings \(2\)](#)


Klikoni foton tuaj të profilit për të parë këto opsione:



- Shto një shkrim personal ([Add a personal note](#)).
- Settings: Në pjesën [settings](#) ju mund të ndryshoni settings të një klienti.
- Ndryshoni statusin tuaj në Available, Away ose Do Not Disturb.
- My Profile: Hapni Webfaqen e Zoom për të edituar profilin tuaj.
- Help: Hapni qendrën e ndihmës të Zoom ([Zoom Help Center](#)).
- Check for Updates: Shikon nëse Zoom është i përditësuar.
- About Zoom: Shikon verzionin aktual të aplikacionit.
- Switch to Portrait View: Kalo në pamjen portret nëse dëshiron që aplikacioni të paraqitet më i ngushtë.

Takimet/Meetings

Selektoni faqen Meetings dhe klikoni Upcoming për të shikuar, filluar, edituar dhe fshirë takimet/meetings e planifikuara.



Ju mund të klikoni opsionet e mëposhtme pas selektimit të një takimi/meeting të planifikuar në panelin në anën e majtë:

- Ikona Shto (+): [Planifiko/Cakto një takim/meeting të ri](#).
- Ikona rifresko (↻): Rifresko listën e takimeve/meetings nëse nuk e shikoni takimin e planifikuar.
- Start: [Filloni takimin e planifikuar](#) që e keni selektuar
- Copy Invitation: Kopjo [tekstin e ftesës](#) së takimit të planifikuar, duke ju lejuar të vendosni (Paste) manualisht në një email, messenger etj. Klikoni *Show Meeting Invitation* nëse doni të shihni ftesën që po kopjoni.
- Edit: Ndryshoni [opsionet e takimit](#) tuaj të planifikuar.
- Delete: Fshini në mënyrë të përhershme takimin tuaj të planifikuar.

Krijimi i takimit


Egzistojnë 2 lloje takimesh, Meet Now (Takime të menjëhershme) dhe Takime të planifikuara.

Takim i planifikuar (Scheduled Meetings)

Ju mund të planifikoni një takim që mund të ndodhë një herë ose një takim që përsëritet. Ka disa mënyra për të planifikuar një takim. Ju mund t'i ftoni pjesëmarrësit në takim përpara kohe dhe të shtoni ftesën në një kalendar ose ta dërgoni atë përmes emailit. Mësoni më shumë rreth [caktimit të takimeve](#) dhe [ID të takimeve](#).

Takim i menjëhershëm (Instant Meetings)

Mund të filloni një takim të menjëhershëm me këto metoda.




Takimi fillon menjëherë dhe ju mund të ftoni të tjerët të bashkohen në këtë takim në çdo kohë.

Ju mund të përdorni [ID tuaj të Takimit Personal](#) për Takime të menjëhershme. Në faqen Home të aplikacionit Zoom, klikoni New Meeting.


Ju gjithashtu mund të klikoni në shigjetën poshtë për opsionet e takimit të menjëhershëm.

Ndërsa në website ju duhet të kyçeni fillimisht dhe të klikoni Host a Meeting për të krijuar një takim.




Ndaj pamjen e ekranit me të tjerët (Sharing your screen)

Kliko butonin Share Screen i cili është i vendosur në panelin e takimit (si më poshtë).



Pastaj zgjedhni pamjen të cilën dëshironi ta ndani me të tjerët. Ju mund ta zgjedhni edhe vetëm pamjen e një aplikacioni që është i hapur në kompjuterin tuaj, ose pamjen e desktopit, ose si [tabel](#) ku mund të shkruani, ose si [IPhone/iPad](#) (si më poshtë).



(Opcionale) Aktivizo këto karakteristika:


- Zgjedh Share Computer Sound: Nëse zgjedhni këtë opcion, çfarëdo muzike/tingulli të cilin jeni duke ndëgjuar në kompjuterin tuaj do të ndahet me të tjerët në meeting.
- Zgjedh Optimize for full screen video clip: Zgjedhni këtë nëse je duke nda me të tjerët një video clip në full mode screen (je duke e transmetuar në ekran të plotë). Ose mos e zgjedhni këtë, pasi mund të bëjë që pamja që shohin të tjerët të jetë i paqartë.

Kliko Share.

- Zoom do të rritet automatikisht në ekran të plotë për të optimizuar pamjen e ekranit që shohin të tjerët. Për të dalë nga ekranin e plotë, klikoni Exit Full Screen në këndin e sipërm të djathtë ose shtypni tastin Esc.
- Për të çaktivizuar kalimin automatik në ekranin e plotë, çaktivizoni këtë mundësi në [desktop client settings](#): Kaloni automatikisht në ekranin e plotë kur një pjesëmarrës ndan ekran me ju.

Menu gjatë ndarjes së ekranit me të tjerët (Share screen menu)

Kur filloni të ndani ekranin tuaj me të tjerët, kontrollet e meeting/takimit do të zhvendosen në një menu që mund të lëvizni nëpër ekranin tuaj.




- Mute/Unmute: Ndalni ose lëshoni mikrofonin tuaj.
- Start/Stop Video: Filloni ose ndaloni videon tuaj brenda takimit.
- Participants/Manage Participants: Shikoni ose [menaxhoni pjesëmarrësit](#) (nëse jeni organizatori i meeting).
- New Share: Filloni një ndarje të re të ekranit me të tjerët. Do t'ju kërkohet të zgjidhni cilin ekran

që doni të ndani përsëri.

- Pause Share: Pazuoni ekranin tënd që jeni duke e ndarë me të tjerët.
Annotate / Whiteboard: Shfaq veglat për [shënimi](#)/vizatim, shtim teksti, etj.

More: Rri me kursor mbi për më shumë opsione shtesë.



- Chat: Hapni dritaren e ku mund të bisedosh me të tjerët.
- Invite: [Fto të tjerët](#) të bashkohen në mbledhje/meeting.
- Record: Filloni të regjistroni pamjen dhe ta ruani [lokalisht](#) në kompjuterin tuaj ose në [cloud](#).
- Allow/Disable participants annotation: Lejoni ose parandaloni pjesëmarrësit të [shënojnë shënimet në ekranin tuaj të përbashkët](#).
- Show/Hide Names of Annotators: Shfaq ose fshih emrin e pjesëmarrësve kur ata shënojnë
- shënime në ekran. Nëse vendoset të shfaqen, emri i pjesëmarrësit do të shfaqet shkurtimisht
- krahas shënimit të tyre si më poshtë.



- Live on Workplace by Facebook: Share your meeting or webinar on Workplace by Facebook. [Learn more about live-streaming a webinar. Learn more about live-streaming a meeting.](#)
- Optimize Share for Full-screen Video Clip: Start optimizing for a video clip in full screen mode. Note: Do not enable this setting if you are not sharing a full screen video clip, as it will blur your screen share.
- End Meeting: Leave the meeting or end the meeting for all participants

Përdorimi me dy ekrane (Using dual monitors)


Nëse jeni duke përdorur kompjuter me dy monitor, mund të aktivizoni funksionin [Use Dual Monitors](#) (Përdorimi me dy ekrane) për të parë pamjen që ndani me të tjerët në një monitor dhe pjesëmarrësit në takim/meeting në monitorin e dytë.

Qasja në Takim përmes shfletuesve në ueb


Pas pranimit të ftesës për takim e cila është e formatit si në linkun në vijim:

<https://us04web.zoom.us/j/357914864?pwd=S0pDUzJkbn1TdWxGVIZpNDJmZHJpUT09>

Hapet forma si në figurën vijuese:



Duhet t; klikoni në butonin **Cancel** nga figura e mësipërme, pastaj do të fitoni ekranin si në figurën vijuese



Pastaj klikoni në [linkun join from your browser](#) dhe do të fitoni ekranin vijues



Klikoni në butonin **Join**, pastaj hapet një ekran tjetër ku duhet të klikoni ne butonin **Join with Computer Audio**

